



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare
Ministarstvo za Rad, Porodicu i Vrednosti Oslobodilačkog Borbe
Ministry of Labour, Family and Values of the Liberation War

SHPALLJE E KONKURISIT

Për përzgjedhjen e anëtarit dhe zëvendës anëtarin në Këshillin Profesional për Shërbime Sociale dhe Familjare nga Organizatat Jo-qeveritare të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare

Bazuar në nenin 36 të Ligjit nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, nenit 3, 4 dhe 5 të Rregullores MD – nr. 08/2024, për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit Profesional për Shërbime Sociale dhe Familjare, ftohen profesionistët e shërbimeve sociale dhe familjare nga Organizatat Jo-qeveritare të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare të aplikojnë për përzgjedhje për anëtar dhe zëvendës anëtarin në Këshillin Profesional të Shërbimeve Sociale dhe Familjare (KPSHSF).

Obligimet, përgjegjësitë e KPSHSF-së dhe kohëzgjatja e mandatit:

- Licencon ofruesit individual për shërbime sociale dhe familjare;
- Zhvillon programe për trajnimin për ofrues individual të shërbimeve sociale dhe familjare.
- Këshillon Ministrin në përcaktimin e prioriteteve të Ministrisë në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare;
- Kohëzgjatja e mandatit të anëtarit dhe zëvendës anëtarin në KPSHSF është katër (4) vjet.

Kriteret për aplikim:

- Të jetë i diplomuar me kualifikim adekuat në fushën e punës sociale, psikologjisë, sociologjisë, drejtësisë, pedagogjisë ose të ndonjë lëmi tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare;
- Të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune në shërbime sociale dhe familjare;
- Të jetë i licencuar si profesionist i shërbimeve sociale dhe familjare.
- Të mos ketë dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës.

Dokumentet e nevojshme:

- Kërkesa për aplikim;
- CV-ja;
- Fotokopja e letërnjoftimit;
- Fotokopja e diplomës (kopje e noterizuar);
- Vërtetimin mbi përvojën e punës (origjinale - kopje e noterizuar);
- Kopja e licencës (Profesionist i shërbimeve sociale dhe familjare);
- Referencë nga Organizata Jo-Qeveritare, dhe
- Certifikatën mbi Dënimet Penale nga Gjykata.

Paraqitja e kërkesave për konkurrim në këtë Këshill do të zgjatë 15 ditë nga dita e publikimit të kësaj ftese publike, përkatësisht nga data 15.04.2026 deri më datën 30.04.2026.

Profesionistët e interesuar, kërkesën me dokumentet e nevojshme për aplikim mund t'i dërgojnë përmes postes elektronike në këtë e-mail adresë: ylber.kokollari@rks-gov.net.

Për çdo informatë shtesë mund të kontaktoni në këta numra telefoni: 038 200 67 454.